



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE
TË KLASËS SË 5-të**

TIRANË, 2016

Përmbajtja

Hyrje	3
Përmbledhje	4
Vlerësimi i arritjeve të nxënësve – klasa 5	6
Kapitulli 1 Objektivat dhe Metodologjia e Vlerësimit	6
Objektivat e Vlerësimit	6
1. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Gjuhës Shqipe	6
2. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Matematikës	7
3. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Dituri Natyre	8
Metodologjia e vlerësimit	9
1. Si u realizua vlerësimi	9
2. Pjesëmarrësit në testim	9
3. Kampionimi i vlerësimit	9
4. Administrimi i të dhënave	10
5. Instrumentet e vlerësimit	10
Kapitulli 2 Arritjet e nxënësve	
1. Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i treguesve statistikore	11
2. Arritjet e nxënësve në vlerësimin e klasës së 5-të	11
3. Arritjet e nxënësve në testin e Gjuhës Shqipe	26
4. Arritjet e nxënësve në testin e Matematikës	33
5. Arritjet e nxënësve në testin e Dituri Natyre	40

Hyrje

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor, synon të japë informacion mbi njohuritë dhe aftësitë që nxënësi merr sot në shkollë. Matja e rezultateve të të nxënësve vazhdimisht po konsiderohet i nevojshëm, jo vetëm për të monitoruar suksesin e një sistemi arsimor, por edhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit.

Rezultatet e arritjeve të të nxënësve shërbejnë në hartimin e politikave arsimore të duhura, me qëllim ndërtimin e një sistemi efektiv dhe të barabartë arsimimi për të gjithë nxënësit e vendit. Vlerësimet kombëtare të arritjeve të nxënësve i shërbejnë arsimit për të gjithë, kur gjenden mënyrat e duhura, për të përkthyer informacionin e mbledhur në praktika dhe politika arsimore efektive.

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor 2016.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes tyre.

Përmbledhje

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë të arsimit fillor synon të japë informacion mbi njohuritë dhe aftësitë që nxënësi merr sot në shkollë në lëndët: gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

Vlerësimi kombëtar i nxënësve të klasës së pestë është një vlerësim, në të cilin kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit që ndjekin klasën e pestë.

Gjetje të vlerësimit kombëtar:

- Arritjet e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës së 5-të rezultojnë të jenë pranë nivelit mesatar të arritjeve. Vetëm rreth **7.41% e nxënësve zotërojnë njohuri të nivelit të lartë dhe 49% e tyre zotërojnë njohuri që i përkasin nivelit mesatar.**
- Puna e mësuesit duhet të përqendrohet kryesisht në zhvillimin e kapaciteteve vëzhguese për zgjidhjen e problemeve, duke përdorur mjete konkrete didaktike.
- Nxënësit preferojnë të përzgjedhin mes përgjigjeve të gatshme, se sa ta modelojnë/ndërtojnë vetë atë (përgjigjen). Në këtë rast ka dy probleme që lidhen me: aftësinë e të kuptuarit dhe aftësinë e të shprehurit.
- Përqendrimi i punës së mësuesit është kryesisht në nivelet e para të kompetencave, pra riprodhim, njohje dhe kuptim të tekstit dhe pak ose aspak i vënë nxënësit në situatë reflektimi dhe vlerësimi dhe thuajse asnjëherë të merren me fragmente tekstesh të panjohura më parë. Kjo sjell që pak nxënës aftësohen në nivele të larta ku kërkohet mendimi kritik, arsyetimi, interpretimi dhe përgjigja personale.
- Rezultatet lidhen me punën e pakët që zhvillohet me nxënësit në drejtim të aftësisë së të shkruarit. Qëllimi i lëndës së gjuhës shqipe është që t'i aftësojë nxënësit të shprehën dhe shkruajnë idetë e tyre në lidhje me tema të caktuara dhe jo thjesht të mbartin aftësi mekanike që shfaqen vetëm në zgjidhje fragmentare ushtrimesh.
- Në matematikë, njohuritë gjeometrike, shtrimi i problemave dhe zgjidhja e tyre janë aftësi që nuk zotërohen mirë nga nxënësit.
- Vajzat kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e djemve.
- Arritjet e nxënësve të qytetit janë më të larta se arritjet e nxënësve në fshat.
- Arritjet e nxënësve në shkollat private janë më të larta se arritjet e nxënësve në shkollat publike. Niveli social-ekonomik i familjeve të nxënësve, numri i nxënësve në klasë, janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë gjetje të vlerësimit kombëtar.

- Një pjesë e mirë e nxënësve shfaqin vështirësi në veprimet me njësitë e njohura të gjatësisë, masës dhe në kryerjen e veprimeve të thjeshta me to. Pjesa më e madhe janë të prirur për të dhënë përgjigje në ato ushtrime, ku mund të kryejnë veprime mekanike dhe jo në të tjerat ku kërkohet arsyetimi logjik.
- Në ciklin fillor lënda “Dituri Natyre” të kryhet mbi bazën e eksperimenteve që mësuesja duhet t’u demonstrojë nxënësve në klasë, në mënyrë që nxënësit të nxënë më shumë. Madje, në orë të caktuara, mësimi duhet të zhvillohet në natyrë, pasi vetëm aty mësimdhënia dhe nxënia bëhet më konkrete. Konkretisht pyetja e cila teston aftësinë e nxënësve për të vënë në zbatim njohuritë e marra, rezulton t’i jenë përgjigjur saktë vetëm 17% e nxënësve.
- Nxënësit duhet të aftësohen në nivele të larta të kompetencave, ku kërkohet mendimi kritik, arsyetimi, interpretimi, përgjigjja personale, zgjidhja problemore.
- Hartimi i programeve trajnuese që lidhen me strategji të procesit të të nxënësve në klasë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
- Ri konceptim i tekstit të nxënësve në lidhje me mënyrën se si duhet t’u mësohen kompetencat.
- Të përcaktohet qartazi niveli bazë i kompetencave gjuhësore që duhet të zotërojë çdo nxënës në përfundim të arsimit fillor.
- Mësuesi duhet ta orientojnë orën e mësimit në zhvillimin e veprimtarive praktike, me qëllim që nxënësi të nxërë duke punuar.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve

Kapitulli 1 Objektivat dhe Metodologjia e Vlerësimit

Objektivat e Vlerësimit

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve në klasën e 5-të, të arsimit të detyruar synon të vlerësojë njohuritë dhe kompetencat bazë, të fituara nga nxënësit në ciklin fillor, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre në përfundim të vitit shkollor 2015-2016. Njëkohësisht, ky vlerësim kombëtar synon të vlerësojë aftësitë e nxënësve për të mbajtur qëndrime aktive ndaj njohurive dhe përvojës së fituar në shkollë, si dhe për të parë nevojat për ndërhyrje apo përmirësime të mëtejshme të komponentëve bazë të procesit mësimor.

1. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Gjuhës Shqipe

Objektivat kryesorë të vlerësimit në testin e **gjuhës shqipe** kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të mëposhtme:

A. Të lexuarit

- identifikon informacionin më të rëndësishëm;
- tregon brendinë e pjesës që lexon;
- identifikon mesazhin e pjesës që lexon;
- analizon personazhin kryesor;
- gjen idetë dhe mesazhin e pjesës së lexuar duke i ilustruar ato me fragmentet përkatëse.

B. Të shkruarit

- parashikon zgjidhje, mbyllje të reja të tregimeve sipas imagjinatës;
- rendit sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti;
- shkruan, përshkrime apo tregime të shkurtra ku përdor fjalë të zgjedhura.

C. Njohuri gjuhësore

- dallon grupin emëror dhe grupin foljor në fjali;
- përcakton klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- përcakton numrin e emrit;
- përcakton mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja;
- shkruan saktë fjalët, shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe;
- gjen përbërësit e fjalës.

Tabela më poshtë (tabela e specifikimeve sipas strukturës së testit) ilustron linjat dhe nën linjat si dhe përqindjet që i takojnë çdo linje. Ndarja është bërë për qartësimin e aftësive që zotëron nxënësi dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht është mbajtur parasysh se linjat janë mësuar të integruara me njëra-tjetrën dhe shpesh janë parë të tilla edhe në kërkesat e testit.

Nr.	Linjat	%	Pikë për linjë	Niveli. I -30%	Niveli II-40%	Niveli III-30%
1	Të lexojmë	50%	10	2	6	2
2	Njohuri gjuhësore	35%	7	1	5	1
3	Të shkruajmë	15%	3		2	1
	TOTALI	100%	20			

2. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Matematikës

Objektivat kryesorë të vlerësimit në testin e **matematikës** kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të mëposhtme:

A. Numri

- kryen mbledhje të dy numrave thyesorë dhe nëpërmjet ilustrimit me figurë shpreh me thyesë pjesën e ngjyrosur
- përdor kuptimin e numrit dhe të veprimeve me të, për të zgjidhur probleme të thjeshta me të dhëna nga mjedisi rrethues dhe jeta e përditshme;
- rendit dhe dallon vlerën më të madhe dhe më të vogël

B. Matja

- kryen veprimet me njësitë e gjatësisë dhe njësitë e masës;
- gjen masën e këndit të trekëndëshit nëse njihen dy kënde të tij;
- përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zbuluar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike.

C. Algjebër

- zgjidh inekuacionin me jo më shumë se dy veprime.

Tabela më poshtë tregon mënyrën e shpërndarjes së pikëve të testit mbi bazën e përqindjes së linjave në programin lëndor si edhe mbi bazën e përqindjes së vështirësive të kërkesave.

Nr.	Linja/Objektivat	% e linjës	Nr. i pikëve	Shkalla e vështirësisë		
				N. I – 30%	N. II. 40%	N. III. 30%
1.	Numri	53	14	5	6	3
2.	Matja	33	4	1	2	1
3.	Algjebra	14	2	1	1	
	TOTALI	100	20	7	9	4

3. Objektivat e vlerësimit në testin e lëndës së Diturisë Natyre

Objektivat kryesorë të vlerësimit në testin e **diturisë natyre** kanë të bëjnë me vlerësimin e kompetencave të mëposhtme:

A. Lëndët dhe vetitë e tyre

- Përcakton kushtet që shkaktojnë ndryshimet nga një gjendje në një tjetër të ujit.
- Demonstron eksperimentalisht që oksigjeni ndihmon djegien dhe e kundërta.

B. Mjedisi fizik

- Bën dallimin midis tingujve të ulët dhe të lartë, të dobët dhe të fortë
- Shpjegon si krijohen eklipsat e Hënës dhe të Diellit dhe bën dallimin midis tyre;
- Tregon cilët janë planetët që përbëjnë sistemin Diellor;
- Përshkruan krijimin e ditë-natës dhe ndryshimin e stinëve, si rezultat i rrotullimit të Tokës

C. Gjallesat dhe proceset e jetës

- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e lules (thekët, si pjesa mashkullore e bimës; pistilin, si pjesa femërore e bimës, farën dhe frytin);
- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e rrënjës (fikson bimën në tokë dhe thith ujin dhe lëndët ushqyese) dhe llojet e saj (si boshtor, xhufkor);
- Identifikon rolin e pjesëve vegjetative të bimës si: rrënjët, gjethet dhe kërcelli, për ushqyerjen e bimës

Tabela më poshtë tregon mënyrën e shpërndarjes së pikëve të testit mbi bazën e përqindjes së linjave në programin lëndor si edhe mbi bazën e përqindjes së vështirësive të kërkesave.

Nr.	Linjat	%	Nr. i pikëve	N. I -30%	N. II-40%	N. III-30%
1	Lëndët dhe vetitë e tyre	20	2	1	1	
2	<i>Mjedisi fizik</i>	38	4	1	2	1
3	<i>Gjallesat dhe proceset e jetës</i>	42	4	2	1	1
	TOTALI		10	4	4	2

Metodologjia e Vlerësimit

Vlerësimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve u realizua përmes një testi të vetëm, të tipit laps-letër. Kërkesat e testit janë: me alternativa, të hapura, gjysmë të strukturuar dhe të strukturuar. Koha e testimit ishte 90 minuta. Testimi u krye në muajin e fundit të procesit mësimor të vitit shkollor 2015-2016. Testi në total përmban 40 kërkesa, ku Gjuha Shqipe ka 18 kërkesa, Matematika 12 kërkesa dhe Dituria e Natyrës 10 kërkesa. Testi në total është vlerësuar me 50 pikë, nga të cilat 20 pikë i përkasin Gjuhës Shqipe, 20 pikë Matematikës dhe 10 pikë Diturisë së Natyrës.

1. Si u realizua vlerësimi

Testimi u zhvillua në të gjitha shkollat e vendit. Administratorët e testimit ishin mësuesit e arsimit fillor të trajnuar nga AKP për të kryer këtë proces. Në përfundim të testimit të gjitha testet u administruan dhe u vlerësuan në mjediset e DAR/ZA. Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve është bërë me pikë. Vlerësimi i çdo përgjigjeje të dhënë nga nxënësi për kërkesën përkatëse, mbështetet në formatin e vlerësimit të përgatitur nga AKP. Secili test i është nënshtruar një vlerësimi të dyfishtë, të pavarur nga njëri tjetri. Vlerësuesit u trajnuan nga specialistët e AKP-së, përpara procesit të vlerësimit.

2. Pjesëmarrësit në testim

Në këtë testim për klasat e pesta u testuan të gjithë nxënësit e regjistruar në klasën e pestë, në vitin shkollor 2015-2016. Numri i nxënësve pjesëmarrës në testim ishte **33980** dhe numri i mungesave ishte **140**. Në total nxënësit që u testuan ishin 33840.

3. Kampionimi i vlerësimit

Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të nxënësve të klasës lidhur me analizën teknike të testit për nxënësit e klasës së 5-të u bazua në vlerësimin e një kampioni përfaqësues nga popullata e nxënësve të klasës së 5-të. Masa e kampionit për vlerësimin u përcaktua si fillim 8540 nxënës, të cilët përbëjnë 25 % të popullatës. Kampioni i nxënësve u bazua në databazën e nxënësve të sistemit arsimor shqiptar për ciklin fillor, klasa e 5-të. Vlerësimi është me bazë klasën e 5-të, pavarësisht moshës së nxënësit që ndjekin klasën e pestë.

Nga popullata e përgjithshme janë përzgjedhur për një analizë të mëtejshme, një kampion përgjigjesh të dhëna nga nxënësit, bazuar në metodën proporcionale. Kampioni u krijua duke bërë një përzgjedhje në bazë të teorive statistikore, në mënyrë që rezultatet e marra nga ky vlerësim, të jenë të vlefshme për të treguar arritjet e nxënësve si dhe tregues të tjerë të pjesëve përbërëse të sistemit arsimor.

Hapat kryesore nëpër të cilat kaloi përzgjedhja e kampionit për analizën teknike ishin:

- a. Përcaktimi i popullatës së studimit dhe modelit të zgjedhjes së kampionit;
- b. Grumbullimi, organizimi dhe përpunimi i të dhënave për formimin e kampionit;

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela e mëposhtme jep treguesit e popullatës së nxënësve dhe raportet për ndryshoret e përcaktuara qytet/fshat, publike/private.

	popullata e plotë e nxënësve të klasës 5				popullata e nxënësve të klasës 5 pjesmarrës në provim				popullata e plotë e nxënësve të klasës 5		popullata e nxënësve të klasës 5 pjesmarrës në provim	
	qytet	fshat	publike	private	qytet	fshat	publike	private	femra	meshkuj	femra	meshkuj
Numri	18920	15060	31831	2149	18830	15010	31706	2134	16728	17252	16652	16988
Përqindja	56%	44%	94%	6%	56%	44%	94%	6%	49%	51%	49.80%	50.20%

Kampioni i përzgjedhur për studim						
	qytet	fshat	publike	private	femra	meshkuj
Numri	4722	3818	8023	517	4097	4443
Përqindja	55.29%	44.71%	93.95%	6.05%	47.97%	52.03%

Kampioni i përzgjedhur për studimin e përgjigjeve është 8540 nxënës.

Nga numri total i nxënësve të testuar, femrat përbëjnë 47.97% të tyre ndërsa numri i meshkujve përbën rreth 52.03%. Nxënësit e fshatit përbëjnë rreth 44.71% të totalit të kampionit.

4. Administrimi i të dhënave

Për të siguruar një proces korrekt të administrimit të të dhënave, u kërkua nga çdo DAR/ZA të caktohej një koordinator rajonal dhe një administrator testi për çdo klasë që do të testohej. Koordinatorët u trajnuan në AKP për procesin që do të administrohej, të cilët më pas trajnuan administratorët e testit. Pas kryerjes së procesit të shumëfishimit të testeve, ato bashke me listat emërore të koduara për çdo shkollë, u paketuan në qese DHL dhe u shpërndanë një ditë para testimit në çdo DAR/ZA. Pas përfundimit të testimit, testet dhe listat emërore të plotësuar me shënimet përkatëse, u dorëzuan në DAR/ZA, ku u administruan dhe u informatizuan. Pas informatizimit të rezultateve u bë lidhja e tyre në bazë të kodit të nxënësit (barkodit) me bazën e të dhënave të shkollave dhe filloi përpunimi statistikor i tyre.

5. Instrumentet e vlerësimit

Instrumenti i përdorur për vlerësimin e nxënësve të klasës së 5-të ishte një test i kombinuar. Testi përbante 40 kërkesa dhe koha e përcaktuar për zgjidhjen e tyre ishte 90 min. Testi i kombinuar përbëhej nga: 18 kërkesa të lëndës së gjuhës shqipe për këtë lëndë; 12 kërkesa të lëndës së matematikës; 10 kërkesa të lëndës dituri natyre;

Raportet: 3:2:1 që zënë në test lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre është realizuar në bazë të peshave që kanë këto lëndë në programin mësimor të klasës së 5-të. Në testin e kombinuar gjuha shqipe dhe matematika kanë nga 20 pikë, ndërsa dituri natyre ka 10 pikë. Testi u shoqërua me një skemë vlerësimi, ku përgjigjja e mundshme e çdo kërkesë ishte e detajuar. Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve nëpërmjet një skeme të tillë, siguron një vlerësim korrekt dhe uniform nga të gjithë vlerësuesit.

Kapitulli 2 Arritjet e nxënësve

1. Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i treguesve statistikore

Pas përfundimit të procesit të testimit, testet e grumbulluara iu nënshtruan procesit të vlerësimit me pikë. Të dhënat e përfuara nga procesi i vlerësimit të çdo testi të plotësuar u hodhën në një format elektronik Excel.

Përpunimi i të dhënave u realizua nga përdorimi i programit SPSS. Nëpërmjet importimit të databazës në programin SPSS u përftua informacion mbi arritjet e nxënësve dhe vështirësive të kërkesave të testit të kombinuar. Analiza e vështirësisë së testit u bazua në modelin Rasch, sipas të cilit rezultoi se vështirësia e testit ishte mbi mesatare.

Në këtë material statistikat janë shprehur në formë tabelore ose grafike. Treguesit e përdorur janë:

1. mesatarja e arritjeve;
2. shmangia mesatare, që tregon shmangien mesatare të të dhënave nga mesatarja e tyre;
3. gabimi standard, që tregon masën e caktuar të gabimit të vlerësimit,
4. intervali i besueshmërisë, tregon zonën/intervalin në të cilën do të ndodhej rezultati i popullatës, referuar rezultatit të vëzhguar.
5. përqindëshat, që tregojnë vlerën nën të cilën gjenden rezultatet

Statistikat rreth arritjeve të nxënësve janë shprehur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR/ZA,
- sipas shkollave publike/private,
- sipas urbanizimit fshat/qytet,
- sipas gjinisëfemra/meshkuj,

Paraqitja e këtyre statistikave lejon kryerjen analizave krahasuese ndërmjet kategorive të ndryshme.

2. Arritjet e nxënësve në vlerësimin e klasës së 5-të

Në Figurën 1 jepet shpërndarja e pyetjeve, sipas nivelit të vështirësisë, për testin e kombinuar. Shpërndarja e mëposhtme tregon se vështirësia e testit të kombinuar është mbi **nivelit mesatar**.




Figura 1

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Në të djathtë të Figurës 1 ndodhen pyetjet, sipas shkallës së nivelit të vështirësisë të secilës prej tyre, ndërsa në të majtë të saj kemi shpërndarjen e nxënësve sipas vlerave të arritjeve të tyre. Nga Figura 1 rezulton se kemi nxënës, të cilët kanë arritje shumë të ulëta, në pyetjet e nivelit të tretë. Kështu në lëndën e gjuhës shqipe, në pyetjen 7, 47.98 % e nxënësve kanë marrë zero pikë. Ndërsa në lëndën e matematikës, në pyetjen 11, 56.71% e nxënësve kanë marrë zero pikë.

Tabela 1 paraqet pyetjet e testit të kombinuar, kodin e pyetjes, lënda që ajo i përket, si dhe përqindjet e nxënësve për çdo përgjigje. **Figura 1** është paraqitja grafike e këtyre të dhënave .

Tabela 1

Pyetja	Pikët	Përqindja	Pyetja	Pikët	Përqindja
G1	0	7.01%	M3	0	11.56%
	1	92.99%		1	11.66%
G2	0	26.75%	M4	2	76.78%
	1	73.25%		0	25.45%
G3	0	35.48%	M5	1	41.28%
	1	64.52%		2	33.28%
G4	0	16.33%	M6	0	31.80%
	1	83.67%		1	8.21%
G5	0	29.14%	M7	2	59.99%
	1	70.86%		0	32.50%
G6	0	24.41%	M8	1	67.50%
	1	75.59%		0	17.43%
G7	0	47.98%	M9	1	2.39%
	1	52.02%		2	3.17%
G8	0	17.92%	M10	3	77.01%
	1	82.08%		0	15.96%
G9	0	34.37%	M11	1	11.76%
	1	65.63%		2	72.27%
G10	0	40.94%	M12	0	22.94%
	1	59.06%		1	77.06%
G11	0	35.89%	D1	0	49.24%
	1	64.11%		1	50.76%
G12	0	37.42%	D2	0	56.71%
	1	62.58%		1	12.24%
G13	0	30.16%	D3	2	31.05%
	1	69.84%		0	20.19%
G14	0	24.02%	D1	1	79.81%
	1	75.98%		0	24.61%
G15	0	4.63%	D2	1	75.39%
	1	95.37%		0	26.97%
G 16	0	23.22%	D3	1	73.03%
	1	76.78%		0	17.09%

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

G 17	0	56.84%	D4	1	82.91%
	1	43.16%		0	24.21%
G 18	0	18.61%	D5	1	75.79%
	1	21.69%		0	82.68%
	2	29.27%	1	17.32%	
	3	30.43%	D6	0	32.56%
M1	0	54.84%	D7	1	67.44%
	1	11.37%		0	27.60%
	2	33.79%	1	72.40%	
M2	0	42.16%	D8	0	11.31%
	1	57.84%		1	88.69%
M3	0	11.56%	D9	0	39.44%
	1	11.66%		1	60.56%
	2	76.78%	D10	0	11.82%
		1		88.18%	

Në **Figurën 2** është paraqitur histograma e shpërndarjes së pikëve të fituara nga nxënësit.




Figura 2

Figura 2 tregon që numri më i madh i nxënësve është përqendruar në intervalin 30 – 42 pikë.

Kjo tregon se niveli i arritjeve të nxënësve është mbi nivelin mesatar.

Në nivel kombëtar mesatarja e arritjeve të nxënësve të klasës së pestë është 33.63 pikë, gabimi standard është 9.02 dhe intervali i besueshmërisë (95%) është]29.82, 42.32[.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Në **Tabelën 2** janë paraqitur përqindëshat referuar shumës së pikëve të fituara në testim. “Përqindëshi 10” tregon se 10% e nxënësve kanë arritje që nuk e kalojnë vlerën e 22.31 pikëve. Po kështu shihet se 95% e nxënësve kanë arritje, vlerat e të cilave shkojnë deri në 46.3 pikë.

Tabela 2

Përqindëshi	Shuma e pikëve të fituara
5	17.01
10	22.31
20	24.35
25	28.44
50	34.65
75	41.21
95	46.3
99	49.2

Tabela 3 jep treguesit e arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të për lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën 3, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë 5.36 pikë më e lartë ndaj mesatares së pikëve të nxënësve të fshatit.

Arritjet sipas gjinisë

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 3 vërejmë se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit.

Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e **Tabelës 3** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht me 4.34 pikë.

Tabela 3

Urbanizimi/publike/private	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
Total		33.63	9.02	0.06
	Femra	34.66	8.70	0.08
	Meshkuj	32.68	9.22	0.08
Fshat		30.68	8.71	0.08
	Femra	31.79	8.49	0.11
	Meshkuj	29.70	8.80	0.11
Qytet		36.04	8.54	0.07
	Femra	37.02	8.13	0.10
	Meshkuj	35.14	8.82	0.07
Publike		34.66	8.99	0.06
	Femra	34.72	8.66	0.09
	Meshkuj	32.64	9.17	0.09
Private		39.00	7.73	0.21
	Femra	39.63	7.37	0.29
	Meshkuj	38.44	7.01	0.30

Figura 4 paraqet mesataren e arritjeve të nxënësve në testin e kombinuar sipas 38 DAR/ZA.

- Nivelin më të ulët të arritjeve e ka **ZA Bulqizë**.
- Nivelin më të lartë të arritjeve e ka **DAR i Tiranës**.




Figura 4

Tabela 4.1 paraqet të dhëna në nivel DAR/ZA lidhur me arritjet mesatare të nxënësve gjithsej, të nxënësve që mësojnë në shkollat e fshatit (shih Tabela 4.2), shkollat e qytetit (shih Tabela 4.3), të nxënësve femra (shih Tabela 4.4) si dhe të nxënësve meshkuj (shih Tabela 4.5)

Tabela 4.1

Arritjet e nxënësve sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	32.64	8.08	0.72
BULQIZË	25.89	7.55	1.10
DELVINË	31.77	8.68	0.76
DEVOLL	37.15	8.35	0.50
DIBER	29.38	8.97	0.30
DURRËS	32.11	9.16	0.17
ELBASAN	33.36	8.41	0.48
FIER	31.81	8.99	0.20
GJIROKASTËR	33.84	9.17	0.49
GRAMSH	29.64	8.25	0.58
HAS	31.36	8.75	1.65
KAMËZ	31.88	8.34	0.20
KAVAJË	35.40	9.52	0.35
KOLONJË	31.29	9.87	1.02
KORÇË	34.17	8.47	0.24
KRUJË	31.92	8.76	0.34
KUÇOVË	29.92	9.61	0.53
KUKËS	32.08	8.51	0.31
KURBIN	30.09	8.88	0.34
LEZHË	30.59	8.60	0.30
LIBRAZHD	29.39	8.16	0.30
LUSHNJE	33.93	7.92	0.68
MALËSI E MADHE	30.25	7.58	0.42
MALLAKASTËR	32.42	8.66	0.46
MAT	28.46	8.85	0.37
MIRDITË	31.14	7.76	0.51
PEQIN	33.36	8.41	0.48
PËRMET	35.05	8.21	0.64
POGRADEC	29.69	8.29	2.07
PUKË	31.14	8.59	0.57
SARANDË	34.03	9.06	0.42
SHKODËR	31.14	8.59	0.57
SKRAPAR	29.41	10.05	0.81
TEPELENË	33.07	8.98	0.94
TIRANË	38.94	7.36	0.10
TIRANË QARK	32.46	8.07	0.20
TROPOJË	38.21	5.93	0.35
VLORE	33.34	9.11	0.26

Të dhënat e Tabelës 4.1 tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **38.94**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **25.89**. Nëntë **DAR/ZA** e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 29 **DAR/ZA** e kanë mesataren më të ulët.

Tabela 4.2 (fshat)

Arritjet e nxënësve të fshat sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	31.21	8.07	0.96
BULQIZË	25.65	8.13	1.46
DELVINË	28.32	8.04	1.01
DEVOLL	35.43	8.85	0.70
DIBER	28.18	8.70	0.34
DURRËS	29.26	8.82	0.26
ELBASAN	33.00	7.38	0.48
FIER	28.58	8.56	0.26
GJIROKASTËR	29.97	9.30	0.93
GRAMSH	29.68	8.21	0.60
HAS	30.89	9.93	2.28
KAMËZ	31.51	8.46	0.22
KAVAJË	33.93	9.35	0.45
KOLONJË	26.94	9.19	1.58
KORÇË	32.23	8.30	0.32
KRUJË	29.76	8.78	0.37
KUÇOVË	27.56	9.83	0.82
KUKËS	31.64	8.26	0.38
KURBIN	26.71	8.34	0.51
LEZHË	29.96	7.98	0.35
LIBRAZHD	28.31	7.67	0.34
LUSHNJE	32.29	7.54	0.79
MALËSI E MADHE	29.33	7.38	0.48
MALLAKASTËR	30.60	8.47	0.60
MAT	26.56	8.53	0.48

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

MIRDITË	29.80	7.74	0.87
PEQIN	33.00	7.38	0.48
PËRMET	28.78	8.42	1.19
POGRADEC	27.69	8.34	2.13
PUKË	28.90	8.65	0.79
SARANDE	31.17	9.06	0.66
SHKODËR	28.90	8.65	0.79
SKRAPAR	23.96	10.14	1.46
TEPELENË	28.97	9.22	0.93
TIRANË	38.94	7.36	0.10
TIRANË QARK	32.47	8.06	0.21
TROPOJË	37.48	6.35	0.47
VLORE	31.75	8.70	0.46

Tabela 4.2 paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve në shkollat e fshatit. Të dhënat e **Tabelës 4.2** tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **38.94**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **25.65**. **Tre DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 35 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Tabela 4.3 (Qytet)

Arritjet e nxënësve të qytetit sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	34.45	7.80	1.04
BULQIZË	26.38	6.51	1.63
DELVINË	35.06	8.01	0.99
DEVOLL	39.39	7.10	0.65
DIBER	32.47	8.92	0.56
DURRËS	34.19	8.84	0.22
ELBASAN	34.25	6.36	0.43
FIER	35.27	8.12	0.25
GJIROKASTËR	35.36	8.68	0.54
GRAMSH	29.17	8.83	2.08
HAS	32.33	5.94	1.98
KAMËZ	33.17	7.77	0.39
KAVAJË	37.34	9.41	0.52
KOLONJË	33.75	9.44	1.22
KORÇË	36.58	8.06	0.35

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

KRUJË	31.78	5.63	0.35
KUÇOVË	31.77	9.04	0.67
KUKËS	32.78	8.87	0.51
KURBIN	32.32	8.52	0.42
LEZHË	31.55	9.40	0.52
LIBRAZHD	32.13	8.73	0.61
LUSHNJË	37.20	7.71	1.14
MALËSI E MADHE	32.83	7.58	0.82
MALLAKASTËR	34.84	8.34	0.68
MAT	30.78	8.69	0.54
MIRDITË	31.86	7.71	0.63
PEQIN	34.62	11.30	1.37
PËRMET	37.77	6.46	0.60
POGRADEÇ	29.69	8.29	2.07
PUKË	33.65	7.84	0.76
SARANDË	35.90	8.57	0.51
SHKODËR	31.44	6.36	0.89
SKRAPAR	31.88	9.02	0.88
TEPELENË	34.36	8.68	0.54
TIRANË	38.94	7.36	0.10
TIRANË QARK	32.32	8.37	0.91
TROPOJË	39.45	4.94	0.48
VLORE	33.98	9.20	0.31

Tabela 4.3 paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve në shkollat e qytetit. Të dhënat e **Tabelës 4.3** tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **38.94**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **25.38**. Njëzet **DAR/ZA** e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 18 **DAR/ZA** e kanë mesataren më të ulët.

Tabela 4.3 (femra)

Arritjet e nxënësve femra sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	33.19	7.70	0.94
BULQIZË	27.90	6.66	1.45
DELVINË	33.25	8.52	1.19
DEVOLL	37.76	8.13	0.69
DIBER	30.00	8.80	0.44
DURRËS	33.13	8.91	0.24
ELBASAN	34.92	7.63	0.32
FIER	32.84	8.83	0.28

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

GJIROKASTËR	34.14	9.13	0.69
GRAMSH	31.57	8.22	0.86
HAS	34.20	3.33	1.05
KAMËZ	28.50	7.83	1.43
KAVAJË	37.29	9.14	0.47
KOLONJË	32.16	10.57	1.59
KORÇË	35.83	7.85	0.33
KRUJË	34.13	8.91	0.24
KUÇOVË	31.06	9.12	0.67
KUKËS	33.18	7.92	0.41
KURBIN	31.43	8.55	0.47
LEZHË	31.45	8.32	0.42
LIBRAZHD	30.63	7.77	0.40
LUSHNJË	35.23	8.06	1.08
MALËSI E MADHE	31.56	7.98	0.64
MALLAKASTËR	33.15	8.35	0.59
MAT	29.51	8.66	0.52
MIRDITË	31.37	7.58	0.74
PEQIN	34.92	7.93	0.67
PËRMET	36.17	8.44	0.94
POGRADEC	32.88	4.67	1.65
PUKË	33.26	8.54	0.82
SARANDE	36.06	8.18	0.54
SHKODËR	32.26	8.54	0.82
SKRAPAR	30.87	9.20	1.12
TEPELENË	33.96	9.13	0.69
TIRANË	39.58	6.94	0.13
TIRANË QARK	33.25	8.01	0.29
TROPOJË	39.01	5.85	0.53
VLORE	34.25	8.75	0.36

Tabela 4.4 paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve femra. Të dhënat e **Tabelës 4.4** tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **39.58**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **27.90**. **Pesëmbëdhjetë DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 23 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Tabela 4.5 (meshkuj)

Arritjet e nxënësve femra sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	32.02	8.51	1.10
BULQIZË	24.27	7.95	1.56
DELVINË	30.79	8.69	0.98
DEVOLL	36.53	8.56	0.73
DIBER	28.87	9.08	0.41
DURRËS	31.19	9.29	0.24
ELBASAN	33.24	9.07	0.36
FIER	30.84	9.05	0.27
GJIROKASTËR	33.55	9.22	0.68
GRAMSH	28.08	7.97	0.75
HAS	29.78	10.41	2.45
KAMËZ	31.16	8.56	0.27
KAVAJË	33.43	9.52	0.50
KOLONJË	30.52	9.24	1.31
KORÇË	33.00	5.66	4.00
KRUJË	31.39	9.29	0.24
KUÇOVË	28.44	10.06	0.84
KUKËS	31.08	8.92	0.45
KURBIN	28.85	9.01	0.48
LEZHË	29.85	8.77	0.41
LIBRAZHD	28.07	8.37	0.45
LUSHNJË	33.04	7.74	0.86
MALËSI E MADHE	29.06	7.01	0.54
MALLAKASTËR	31.51	8.99	0.72
MAT	27.47	8.92	0.52
MIRDITË	30.96	7.94	0.71
PEQIN	32.03	8.59	0.66
PËRMET	33.96	7.88	0.86
POGRADEC	26.50	10.11	3.58
PUKË	30.11	8.55	0.79
SARANDË	32.16	9.43	0.60
SHKODËR	31.11	8.55	0.79
SKRAPAR	28.29	10.57	1.13

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

TEPELENË	32.96	9.22	0.68
TIRANË	38.30	7.70	0.15
TIRANË QARK	31.69	8.06	0.28
TROPOJË	37.62	5.94	0.46
VLORE	32.53	9.34	0.37

Tabela 4.5 paraqet të dhëna lidhur me arritjet mesatare të nxënësve meshkuj. Të dhënat e **Tabelës 4.4** tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **38.30**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **24.27**. **Katër DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 34 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Për një analizë më të detajuar për shumën e pikëve të fituara në testin e kombinuar kemi përfutur nivelet me pikët respektive të mëposhtme.

Tabela 5

Nivelet e arritjes	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
Pikët përkatëse të nivelit	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50
Niveli i njohurive që zotërohet	i pamjaftueshëm	minimal	nën mesatar	mesatar	mbi mesatar	i lartë	shumë lartë

Tabela 6 jep shpërndarjen e nxënësve sipas 6 niveleve bazë të zotërimit të njohurive për të gjitha nivelet e arritjeve.

Tabela 6

Nivelet e arritjes	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
Pikët	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50
Totali	0.97%	4.53%	11.30%	20.40%	28.68%	26.60%	7.41%
Totali Femra	0.28%	1.73%	4.72%	8.90%	14.09%	14.26%	4.10%

Fshat	0.63%	3.06%	7.12%	11.93%	13.17%	8.07%	1.03%
Fshat Femra	0.25%	1.21%	2.79%	7.96%	8.78%	4.61%	0.55%

Privat	0.02%	0.05%	0.29%	0.64%	1.45%	2.34%	1.09%
Privat Femra	0.01%	0.02%	0.12%	0.51%	0.61%	1.34%	0.66%

Të dhënat e Tabelës 6 janë paraqitur grafikisht në Figurat 5, 6 ,7 të cilat tregojnë ndryshueshmërinë e përqindjes së nxënësve që i përkasin nivelit 0 të arritjeve për secilën kategori të nxënësve.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të




Figura 5




Figura 6




Figura 7

3. Arritjet e nxënësve në Testin e Gjuhës Shqipe

3.1. Pikët mesatare sipas DAR/ZA

Tabela GJ – 1 jep informacion rreth numrit të nxënësve, për të cilët janë nxjerrë të dhënat statistikore, mesataren kombëtare të arritjeve dhe gabimin standard dhe tregues të tjerë statistikorë.

Tabela GJ-1

Nr i nxënësve	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
33840	13.79	14	0.024	3.96	15.76

- Pjesëmarrja në testim ishte **99.59%**, ndërsa përqindja e mungesave 0.41%.
- Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 13.79 nga 20 pikë të lëndës gjuhë Shqipe
- Vlera e mesme e arritjeve është 14.00.
- Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.024.
- Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard 3.96 tregon se shumica e nxënësve kanë marrë pikët në intervalin 6 deri në 16.

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga perpunimi i rezultateve të 33840 nxënësve që dhanë testin e gjuhës shqipe për klasën e 5-të.

Tabela GJ – 2 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për çdo DAR/ZA.

Tabela GJ – 2

	Mesatarja	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Median	Varianca
BERAT	13.39	0.30	3.39	13.00	11.46
BULQIZË	10.36	0.50	3.46	11.00	11.98
DELVINË	12.68	0.32	3.62	13.00	13.09
DEVOLL	14.57	0.23	3.81	15.00	14.48
DIBER	11.87	0.13	3.91	12.00	15.29
DURRËS	13.28	0.08	4.09	14.00	16.75
ELBASAN	13.48	0.06	4.12	14.00	16.70
FIER	12.87	0.09	3.99	13.00	15.96
GJIROKASTËR	14.73	0.20	3.78	15.00	14.29
GRAMSH	11.50	0.25	3.59	11.00	12.91
HAS	12.29	0.79	4.20	13.00	17.62
KAMËZ	13.34	0.09	3.75	14.00	14.07
KAVAJË	14.46	0.14	3.90	15.00	15.19
KRUJE	13.40	0.14	3.96	14.00	14.96
KOLONJË	13.24	0.44	4.25	15.00	18.04
KORÇË	13.80	0.11	3.82	14.00	14.56

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

KUÇOVË	12.63	0.23	4.20	13.00	17.68
KUKËS	12.44	0.13	3.75	13.00	14.09
KURBIN	12.36	0.16	4.10	12.00	16.78
LEZHË	12.83	0.13	3.81	13.00	14.49
LIBRAZHID	12.08	0.14	3.71	12.00	13.78
LUSHNJE	13.74	0.31	3.68	14.00	13.54
MALËSI E MADHE	12.35	0.19	3.42	12.00	11.69
MALLAKASTËR	12.73	0.20	3.78	13.00	14.32
MAT	11.63	0.17	3.99	12.00	15.88
MIRDITË	12.84	0.25	3.74	13.00	14.02
PEQIN	13.07	0.22	3.97	13.00	15.72
PËRMET	14.26	0.30	3.84	15.00	14.71
POGRADEC	14.25	0.15	3.42	15.00	11.68
PUKË	12.74	0.26	3.96	13.00	15.69
SARANDË	14.36	0.17	3.65	15.00	13.30
SHKODËR	14.15	0.25	3.50	14.00	12.22
SKRAPAR	12.21	0.33	4.16	12.00	17.33
TEPELENE	13.18	0.73	3.43	14.00	11.77
TIRANË	16.10	0.04	3.12	17.00	9.75
TIRANË QARK	12.98	0.09	3.77	13.00	14.21
TROPOJË	14.64	0.18	3.04	15.00	9.25
VLORE	14.02	0.11	3.85	15.00	14.80
TOTAL	13.79	0.02	3.96	14.00	15.67

Të dhënat e **Tabelës GJ-2** tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka **DAR Tirana**, respektivisht **16.10**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqiza**, respektivisht **10.36**. **11 DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 27 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Tabela GJ – 3 jep informacion rreth arritjeve të nxënësve në testin e Gjuhës Shqipe në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën GJ-3, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë 2.54 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.

Arritjet sipas gjinisë

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve sipas gjinisë, të paraqitura në Tabelën GJ-3, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara në testin e gjuhës shqipe për vajzat e qytetit është 1.16 pikë më e lartë kundrejt vajzave të fshatit.

Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e **Tabelës GJ-3** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht me 2.25 pikë.

Tabela GJ-3

Urbanizimi/ publik/privat	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
Total		13.78	3.96	0.02
	Femra	14.38	3.84	0.03
	Meshkuj	13.23	3.99	0.03
Fshat		12.38	3.87	0.04
	Femra	12.96	3.83	0.05
	Meshkuj	11.85	3.82	0.05
Qytet		14.92	3.66	0.03
	Femra	15.53	3.45	0.04
	Meshkuj	14.36	3.76	0.03
Publike		13.76	3.95	0.03
	Femra	14.37	3.83	0.04
	Meshkuj	13.2	3.98	0.04
Private		16.01	3.33	0.91
	Femra	16.63	3.01	0.12
	Meshkuj	15.46	3.51	0.13

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në **tabelën GJ-4**.

Tabela GJ-4

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
Pikët	0-5 pikë	6-11 pikë	12-16 pikë	17-20 pikë
Nr. i nxënësve	1658	7546	14856	9780
%	4.90%	22.30%	43.90%	28.90%

- Totali i nxënësve pjesëmarrës: 33840
- Numri më i madh i nxënësve është përqendruar në intervalin 12-16 pikë, që i takon nivelit mirë.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Përshkrimi i niveleve:

Niveli 0: në të bëjnë pjesë nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues.

Niveli 1: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë njohuritë dhe shprehitë bazë të gjuhës shqipe, p.sh: të identifikojnë klasat e fjalëve, të identifikojnë kohën e foljes, llojin e fjalisë sipas kumtimit, të tregojnë se e kuptojnë përmbajtjen e pjesës, të identifikojë informacionin më të rëndësishëm.

Niveli 2: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta si: të identifikojnë idenë kryesore të një pjese, të analizojnë personazhin kryesor, të shkruajnë mesazhin e pjesës që lexuan, të gjejnë kuptimin e një fjale nisur nga konteksti i dhënë, të identifikojë informacionin më të rëndësishëm, të gjejnë rasën e emrit, të ndërtojnë fjali sipas kërkesave të dhëna, të zgjerojnë kryefjalën në një fjali.

Niveli 3: Këta nxënës zotërojnë aftësi të larta për të shkruar një tekst të organizuar mirë, qartë dhe pa gabime, të krijojnë një histori që ka një fillim, një zhvillim dhe në mbyllje. të rendisin sipas rrjedhës logjike paragrafët në hartimin e një teksti, të rendisin ngjarjet sipas rendit kronologjik, të arrijnë në përfundime.

Tabela GJ-5 tregon përqindjet e nxënësve për çdo kategori përgjigjesh të kërkesave të testit të lëndës së Gjuhës Shqipe. Për kërkesën 17, 56.84% kanë marrë zero pikë, ndërsa është interesante që kërkesës 15, i janë përgjigjur saktë 95.37%.

Tabela GJ-5

Kërkesa	Pikët	Përqindja	Kërkesa	Pikët	Përqindja
G1	0	7.01%	G11	0	35.89%
	1	92.99%		1	64.11%
G2	0	26.75%	G12	0	37.42%
	1	73.25%		1	62.58%
G3	0	35.48%	G13	0	30.16%
	1	64.52%		1	69.84%
G4	0	16.33%	G14	0	24.02%
	1	83.67%		1	75.98%
G5	0	29.14%	G15	0	4.63%
	1	70.86%		1	95.37%
G6	0	24.41%	G 16	0	23.22%
	1	75.59%		1	76.78%
G7	0	47.98%	G 17	0	56.84%
	1	52.02%		1	43.16%
G8	0	17.92%	G 18	0	18.61%
	1	82.08%		1	21.69%
G9	0	34.37%		2	29.27%
	1	65.63%		3	30.43%
G10	0	40.94%			
	1	59.06%			

Nga tabela e mësipërme rezulton se: nxënësit zgjidhin mirë dhe shumë mirë të gjitha pyetjet e nivelit të

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

parë dhe të dytë dhe të tretë (mbi 50% e tyre). Pyetja 17, pyetje e nivelit tretë është zgjidhur vetëm nga 43%. Pra ata shfaqin vështirësi në renditjen e fjalive sipas rendit për të krijuar një tekst.

Për rubrikën të shkruajmë, vlerësimi përgjigjeve është bërë duke përdorur kriterin holistik (të përgjithshëm), pra përshtypja që lë i gjithë punimi i nxënësit, duke pasur parasysh, idenë, organizimin, fjalorin dhe saktësinë drejtshkrimore.

Më konkretisht:

Përgjigja me 3 pikë (shumë e mirë) përmbush këto kritere:

- Zhvillon dhe formëson një informacion me detaje të përzgjedhura shumë mirë, përgjatë të gjithë përgjigjes.
- Shfaq një organizim shumë i mirë kur kalon nga një paragraf në tjetrin.
- Shfaq shumëllojshmëri të strukturave të fjalisë dhe një përzgjedhje shumë të mirë të fjalëve (leksik i pasur).
- Ka shumë pak ose aspak gabime gramatikore, drejtshkrimore dhe shenja pikësimi, të cilat nuk ndikojnë në përgjigjen e dhënë.

Përgjigja me 2 pikë (e mjaftueshme) përmbush këto kritere:

- Përdor disa detaje në informacionin e dhënë;
- Shfaq ide që janë përgjithësisht të lidhura, por ka pak ose aspak kalime nga njëra te tjetra.
- Shfaq një lloj kontrolli në sintaksë, por fjalët dhe fjalitë e përzgjedhura janë të thjeshta dhe jo të shumëllojshme.
- Gabimet në gramatikë, drejtshkrim dhe shenja pikësimi nuk ndikojnë në idenë e shprehur.

Përgjigja me 1 pikë (e dobët) përmbush këto kritere:

- Përsërit informacion ose e ka të fragmentarizuar apo të pazhvilluar si duhet.
- Shfaq mendimet të palidhura si duhet ose jep përgjigje shumë të shkurtër për ta pasur të organizim.
- Ka një kontroll minimal në sintaksë; përzgjedhja e fjalëve shpesh është e pasaktë.
- Gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore dhe në shenjat e pikësimit ndikojnë në idenë e shprehur.

Në esenë, ku nxënësve iu kërkohet **të krijojnë një ngjarje**, arritjet janë si më poshtë:

- **18.61% e nxënësve ka marrë 0 pikë.**
- 21.69% e nxënësve janë vlerësuar me 1 pikë.
- 29.27% e nxënësve janë vlerësuar me 2 pikë.
- 30.43% e nxënësve janë vlerësuar me 3 pikë.

Shikojmë se 18.61% e të testuarve kanë marrë 0 pikë, ndërkohë që 21.69 kanë marrë 1 pikë. Pra rreth 40% e nxënësve janë dobët ose shfaqin kompetenca minimale në rubrikën të shkruajmë. Ndërkohë kemi një përqindje relativisht të mirë, 30.43% të nxënësve që shfaqin kompetenca shumë të mira. Gjithësesi mendojmë se në këtë drejtim mbetet ende shumë punë për t'u bërë nga mësuesit, në drejtim të aftësive të nxënësve për të shkruar, pasi kjo është një kompetencë që atyre do t'u shërejë për gjatë gjithë jetës.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela GJ-6 paraqet vlerat e përqindëshave, duke treguar se, 10% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen nën 8.4 pikë, që i përket nivelit 0 të arritjeve, ku njohuritë që zotërojnë nxënësit janë të pamjaftueshme. Gjithashtu vëmë re se rreth 50 % të nxënësve kanë marrë pikë mbi mesataren.

Tabela GJ-6

Përqindëshat	Shuma e pikëve të fituara
10	8.4
20	10.2
25	11.3
30	12.4
40	13.45
50	15.2
60	16.3
70	16.7
75	17.2
80	17.9
90	18.2

Tabela GJ-7 tregon treguesit psikometrikë të çdo kërkesë të testit të lëndës së Gjuhës Shqipe. Si mund të dallohet nga tabela e mëposhtme të pothuajse gjitha pyetjet kanë lakueshmëri negative, pra shpërndarja nuk është normale por e spostuar majtas. Gjithashtu vërejmë se edhe vlera e Kurtosis është në pjesën më të madhe të kërkesave negative, pra shpërndarja nuk është një shpërndarje Gaussiane por një shpërndarje më e sheshtë.

Kërkesa	Mesatarja	Shmangia standarte	Lakueshmeria	Kurtosis
G1	0.93	0.26	-3.36	9.27
G2	0.73	0.44	-1.04	-0.91
G3	0.64	0.48	-0.60	-1.64
G4	0.84	0.37	-1.82	1.31
G5	0.71	0.46	-0.91	-1.17
G6	0.76	0.43	-1.19	-0.58
G7	0.52	0.50	-0.07	-1.99
G8	0.82	0.38	-1.67	0.78
G9	0.66	0.48	-0.65	-1.57
G10	0.59	0.49	-0.37	-1.87
G11	0.64	0.48	-0.58	-1.66
G12	0.62	0.48	-0.52	-1.73
G13	0.70	0.46	-0.86	-1.25
G14	0.76	0.43	-1.22	-0.52
G15	0.95	0.21	-4.32	16.64
G16	0.77	0.42	-1.27	-0.40
G17	0.43	0.50	0.28	-1.92
G18	1.72	1.09	-0.28	-1.22

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Figura GJ-1 tregon histogramën e shpërndarjes së pikëve të fituara nga nxënësit në testin e Gjuhës Shqipe. Shihet se, numri më i madh i nxënësve ndodhet në intervalin 12-16 pikë.




Figura GJ-1

Figura GJ-2 paraqet shpërndarjen e përqindjeve të nxënësve sipas niveleve të arritjeve. Të dhënat tregojnë se:

- 4.9% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në nivelin 0 të arritjeve,
- në nivelin 1 të arritjeve rezulton të jenë 22.30% e nxënësve,
- përqindja më e madhe e nivelit të arritjeve i takon nivelit 2, me 43.9%.




Figura GJ-2

Pra, 27.2% nxënësve të klasës së pestë kanë marrë pikë që i përkasin nivelit 0 ose nivelit 1 të arritjeve, që tregon se, njohuritë e zotëruara prej tyre janë të pamjaftueshme ose minimale.

4. Arritjet e nxënësve në testin e Matematikës

4.1. Pikët mesatare sipas DAR/ZA

Tabela M – 1 jep informacion rreth numrit të nxënësve, për të cilët janë nxjerrë të dhënat statistikore, mesataren kombëtare të arritjeve dhe gabimi standard dhe tregues të tjerë statistikorë.

Tabela M-1

Nr i nxënësve	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
33840	12.84	13.00	0.03	4.50	20.34

- Pjesëmarrja në testim është **99.59%**, ndërsa përqindja e mungesave 0.41%.
- **Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 12.84.**
- Vlera e mesme e arritjeve është 13.00.
- Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.028.
- Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard është 4.5 që mund të konsiderohet i lartë pra vlerat janë të shpërndara në një grup më të madh.

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga perpunimi i rezultateve të 33840 nxënësve që dhanë testin e matematikës për klasën e 5-të.

Tabela M – 2 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për çdo DAR/ZA.

Tabela M – 2

DAR/ZA	Mesatarja	Mediani	Varianca	Devijimi standard	Gabimi Standard
BERAT	12.42	13.00	17.74	4.21	0.37
BULQIZË	9.83	11.00	14.32	3.78	0.55
DELVINË	12.33	13.00	18.32	4.28	0.38
DEVOLL	14.76	16.00	15.76	3.97	0.24
DIBER	11.21	11.00	20.85	4.57	0.15
DURRËS	12.07	13.00	20.05	4.48	0.08
Elbasan	12.40	13.00	20.01	4.52	0.09
FIER	12.20	13.00	20.27	4.50	0.10
GJIROKASTËR	12.05	13.00	22.60	4.75	0.25
GRAMSH	11.64	12.00	18.51	4.30	0.30
HAS	12.54	12.50	14.78	3.84	0.73
KAMËZ	11.72	12.00	20.20	4.49	0.10
KAVAJË	13.87	15.00	23.47	4.84	0.18
KOLONJË	11.38	12.00	21.25	4.61	0.48
KORÇË	13.11	14.00	17.33	4.16	0.12
KRUJE	12.93	13.00	16.41	4.32	0.21

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

KUÇOVË	10.75	11.00	21.52	4.64	0.26
KUKËS	12.91	14.00	18.46	4.30	0.15
KURBIN	11.30	12.00	19.62	4.43	0.17
LEZHË	11.15	11.00	19.03	4.36	0.15
LIBRAZHD	10.89	11.00	17.29	4.16	0.15
LUSHNJË	12.80	13.00	16.33	4.04	0.35
MALËSI E MADHE	11.25	11.00	16.92	4.11	0.23
MALLAKASTËR	13.36	14.00	18.71	4.33	0.23
MAT	10.71	11.00	21.75	4.66	0.20
MIRDITË	11.59	12.00	15.89	3.99	0.26
PEQIN	13.30	14.00	18.16	4.26	0.24
PËRMET	13.28	14.00	14.59	3.82	0.30
POGRADEC	14.43	16.00	16.96	4.12	0.18
PUKË	11.48	12.00	17.16	4.14	0.27
SARANDË	12.54	13.00	21.31	4.62	0.21
SHKODËR	14.03	15.00	16.46	4.06	0.29
SKRAPAR	10.86	11.00	22.39	4.73	0.38
TEPELENE	10.77	11.50	23.23	4.82	1.03
TIRANË	14.98	16.00	14.81	3.85	0.05
TIRANË QARK	12.78	13.00	16.02	4.00	0.10
TROPOJË	15.99	17.00	11.40	3.38	0.20
VLORE	14.36	15.00	12.21	4.23	0.23
Total	12.84	13.00	20.24	4.50	0.03

Të dhënat e **Tabelës M-2** tregojnë se çdo nxënës mesatarisht ka fituar 10 pikë, pra sa gjysma e pikëve të testit. Mesataren më të lartë të pikëve e ka **ZA Tropojë**, respektivisht **15.99**, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqizë**, respektivisht 9.83. **13 DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve kombëtare, ndërsa 25 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**

Tabela M – 3 jep informacion rreth arritjeve të nxënësve në testin e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën M-3, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara në testin e matematikës për vajzat e qytetit është 1.16 pikë më e lartë kundrejt vajzave të fshatit.

Arritjet sipas gjinisë

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve sipas gjinisë, të paraqitura në Tabelën M-3, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, në sistemin publik, ndërsa djemtë kanë rezultate më të larta në sistemin privat.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara në testin e gjuhës shqipe për vajzat e qytetit është 1.88 pikë më e lartë kundrejt arritjeve të vajzave të fshatit.

Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e **Tabelës M-3** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht prej 2.24 pikë. Në sistemin publik femrat kanë arritje më të larta se meshkujt, ndërsa në sistemin privat është e kundërta me një diferencë shumë të vogël.

Tabela M-3

Urbanizimi/publike/private	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
Total		12.84	4.51	0.03
	Femra	13.16	4.35	0.04
	Meshkuj	12.54	4.63	0.03
Fshat		11.74	4.46	0.41
	Femra	12.12	4.32	0.57
	Meshkuj	11.38	4.56	0.58
Qytet		13.73	4.35	0.04
	Femra	14	4.19	0.05
	Meshkuj	13.49	4.48	0.05
Publike		12.37	4.49	0.03
	Femra	12.71	4.34	0.09
	Meshkuj	11.86	4.63	0.1
Private		14.61	3.18	0.22
	Femra	14.57	3.91	0.16
	Meshkuj	14.65	4.02	0.15

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në **tabelën M-4**.

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
Pikët	0-5 pikë	6-11 pikë	12-16 pikë	17-20 pikë
Nr. i nxënësve	992	10155	14896	7797
%	2.93%	30.01%	44.02%	23.04%

- Totali i nxënësve pjesëmarrës: 33840
- Prej tyre rreth 44.02 % kanë rezultuar të jenë në nivelin 12-16 pikë, pra në nivelin 2.

Përshkrimi i niveleve:

Niveli 0: në të bëjnë pjesë nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues. Nisur nga tabela 3 % e nxënësve janë të nivelit 0 në njohuritë që zotërojnë.

Niveli 1: është konsideruar si niveli bazë i aftësisë, në të cilën nxënësit demonstrojnë kompetencat e tyre në matematikë të cilat do të shërbejnë si bazë për vitet e mëvonshme të arsimit të tyre.

Shembull:

Pyetja 6 (67 % e nxënësve janë vlerësuar me 1 pikë).

Kompetenca: Kryen veprimet bazë si mbledhje, zbritje, shumëzim të numrave.

Niveli 2: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta.

Shembull:

Pyetja 3(76% janë vlerësuar me pikët maksimale)

Kompetenca: kryen veprimet me numra, përshkruan kërkesat e problemeve të thjeshta, identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra.

Niveli 3: Nxënësit e këtij niveli janë nxënësit me arritjet më të larta. 23% e tyre kanë marrë nga 17-20 pikë. Këta nxënës zotërojnë aftësi të larta në zgjidhjen me saktësi (dhe me mënyra të ndryshme) të situatave problemore matematike.

Shembull:

Pyetja 5 (50% kanë marrë pikë të plota)

Kompetenca: Shtrimi i problemit dhe zgjidhja e tij me kërkesa.

Tabela M-5 tregon përqindjet e nxënësve për çdo kategori përgjigjesh të kërkesave të testit të lëndës Matematikës. Për kërkesën 11, 56.71% kanë marrë zero pikë, ndërsa është interesante që kërkesës 12, i janë përgjigjur saktë 79.81%.

Tabela M-5

Kërkesa	Pikët e kërkesës	Përqindja	Kërkesa	Pikët e kërkesës	Përqindja
M1	0 pikë	54.84%	M7	0 pikë	17.43%
	1 pikë	11.37%		1 pikë	2.39%
	2 pikë	33.79%		2 pikë	3.17%
M2	0 pikë	42.16%	M8	3 pikë	77.01%
	1 pikë	57.84%		0 pikë	15.96%
M3	0 pikë	11.56%		1 pikë	11.76%
	1 pikë	11.66%	2 pikë	72.27%	
	2 pikë	76.78%	M9	0 pikë	22.94%
M3	0 pikë	11.56%		1 pikë	77.06%
	1 pikë	11.66%	M10	0 pikë	49.24%
	2 pikë	76.78%		1 pikë	50.76%
M4	0 pikë	25.45%	M11	0 pikë	56.71%
	1 pikë	41.28%		1 pikë	12.24%
	2 pikë	33.28%		2 pikë	31.05%
M5	0 pikë	31.80%	M12	0 pikë	20.19%
	1 pikë	8.21%		1 pikë	79.81%
	2 pikë	59.99%			
M6	0 pikë	32.50%			
	1 pikë	67.50%			

Nga tabela e mësipërme rezulton se nxënësit kanë njohuri të mira në kryerjen e veprimeve bazë, por kanë vështirësi në njohuritë gjeometrike, njehsimin e peshës, në shtrimin e problemave dhe në zgjidhjen e tyre.

Më konkretisht vështirësitë më të shumta janë:

- në renditjen dhe dallimin e vlerave më të mëdha dhe më të vogla. Më shumë se gjysma e nxënësve vlerësohen me 0 pikë;
- në përvetësimin e njohurive gjeometrike (41% e tyre vlerësohen me 1 pikë nga 2 pikë të mundshme). Kjo është një nga fushat ku nxënësit shfaqin vështirësi. Konkretisht, në pyetjen e dhënë nxënësi duhet të zbatojë përkufizimin për shumën e këndeve të një trekëndëshi dhe më pas të bëjë diferencën me dy këndet e dhëna për të gjetur këndin e panjohur. Në bazë të vlerës së gjetur të këndit duhet të emërtojë dhe figurën gjeometrike).
- në njehsimin e peshës. Për këtë pyetje 42% e nxënësve kanë marrë 0 pikë, pra nuk kanë vepruar fare ose e kanë zgjidhur gabim. Kjo pyetje ka rezultuar e një niveli të lartë vështirësie. Ndryshe nga viti i kaluar, kjo pyetje ka një përqindje më të lartë të nxënësve që janë përgjigjur saktë pasi ka qenë pyetje me alternativë.
- në shtrimin e problemave dhe në zgjidhjen e tyre (31% të nxënësve kanë marrë 0 pikë nga 2 pikë të mundshme). Problem mbetet arsytimi i problemit nga ana e nxënësit pasi veprimet mekanike janë më të thjeshta për tu bërë prej tyre.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

- në zgjidhjen e inekuacioneve. Për këtë pyetje 57% e nxënësve vlerësohen me 0 pikë dhe vetëm 30% e tyre kanë marrë pikë maksimale.
- Në emërtimin e një figure geometrike e cila formohet nga bashkimi i pikave në rrjetin koordinativ. Rreth 49 % e tyre vlerësohen me 0 pikë pra nuk arrijnë të japin përgjigje saktë.

Tabela M-6 paraqet vlerat e përqindëshave, duke treguar se 10% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen nën vlerën 5.2 pikë, që i përket nivelit 0 të arritjeve, ku njohuritë që zotërojnë nxënësit janë të pamjaftueshme. Ndërkohë vëmë re se rreth 50 % e nxënësve kanë marrë pikë mbi mesataren.

Tabela M-6

Përqindëshat	Shuma e pikëve të fituara
10	5.2
20	9.3
25	10.2
30	11.5
40	12.4
50	13.5
60	14.3
70	15.2
75	16.3
80	17.2
90	18.4

Tabela M-8 tregon treguesit psikometrikë të çdo kërkesë të testit të Matematikës.

Tabela M-8

Kërkesa	Mesatarja	Shmangia standarte	Lakueshmeria	Kurtosis
M1	0.79	0.92	0.43	-1.68
M2	0.58	0.49	-0.32	-1.90
M3	1.65	0.68	-1.68	1.26
M4	1.08	0.76	-0.13	-1.27
M5	1.28	0.92	-0.59	-1.55
M6	0.68	0.47	-0.75	-1.44
M7	2.40	1.15	-1.50	0.35
M8	1.56	0.75	-1.34	0.10
M9	0.77	0.42	-1.29	-0.34
M10	0.51	0.50	-0.03	-2.00
M11	0.74	0.90	0.53	-1.56
M12	0.80	0.40	-1.49	0.21

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Figura M-1 tregon histogramën e shpërndarjes së pikëve të fituara nga nxënësit në testin e Matematikës. Shihet përqëndrimi më i madh i tyre shtrihet në intervalin 12-18 pikë.




Figura M-1

Figura M-2 tregon shpërndarjen sipas niveleve. Shpërndarja e përqindjeve të nxënësve sipas niveleve të arritjeve të paraqitura në Figurën M-2 tregojnë se 2.93% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në nivelin 0 të arritjeve, ndërsa në nivelin 1 të arritjeve rezultojnë të jenë 30.01% e nxënësve.




Figura M-2

5. Arritjet e nxënësve në Testin e Diturisë së Natyrës

5.1 Pikët mesatare sipas DAR/ZA-ve

Tabela D-1 jep informacion rreth numrit të nxënësve, për të cilët janë nxjerrë të dhënat statistikore, mesataren kombëtare të arritjeve dhe gabimi standard.

Tabela D-1

Nr i nxënësve	Mesatarja	Median	Gabimi standard i mesatares	Devijimi standard	Varianca
33840	7.02	7	0.012	1.92	3.69

Pjesëmarrja në testim është **99.56%**, ndërsa përqindja e mungesave 0.41%.

- **Mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve është 7.02.**
- **Kjo tregon se niveli i arritjeve të nxënësve është mbi nivelin mesatar**
- Vlera e mesme e arritjeve është 7.
- Gabimi standard i mesatares, i cili tregon se sa afër është mesatarja e studimit me mesataren e popullsisë, është 0.012.
- Devijimi standard i ulët do të thotë se pikat e të dhënave janë të grupuara shumë afër të njëjtës vlerë (mesatare), ndërsa devijimi standard i lartë nënkupton se të dhënat janë të vendosura në një grup më të madh vlerash. Në rastin tonë devijim standard është 1.92

Përfundimet e mësipërme u nxorën nga perpunimi i rezultateve të 33840 nxënësve që dhanë testin e diturisë së natyrës për klasën e 5-të.

Mesatarja e arritjeve të nxënësve në testin e Dituri Natyre është 7.02 pikë, gabimi standard është 0.012 dhe intervali i besueshmërisë (95%) është [6.46, 7.58].

Tabela D – 2 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për çdo DAR/ZA.

Arritjet e nxënësveve sipas DAR/ZA	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
BERAT	6.83	1.63	0.14
BULQIZË	5.7	1.96	0.29
DELVINË	6.76	2.13	0.19
DEVOLL	7.82	1.76	0.11
DIBER	6.29	2.03	0.07
DURRËS	6.76	1.95	0.04
ELBASAN	7.01	1.97	0.04
FIER	6.74	1.9	0.04
GJIROKASTËR	7.06	1.89	0.1
GRAMSH	6.49	1.95	0.14
HAS	6.54	2.05	0.39

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

KAMËZ	6.81	1.8	0.04
KAVAJË	7.08	2.16	0.08
KOLONJË	6.66	1.98	0.2
KORÇË	7.26	1.87	0.05
KUÇOVË	6.54	2.03	0.11
KUKËS	6.72	1.93	0.07
KRUJE	6.65	2.11	0.12
KURBIN	6.44	1.93	0.07
LEZHË	6.6	1.96	0.07
LIBRAZHD	6.45	2	0.07
LUSHNJE	7.41	1.66	0.14
MALËSI E MADHE	6.65	1.81	0.1
MALLAKASTËR	6.33	2.09	0.11
MAT	6.13	2.06	0.09
MIRDITË	6.71	1.81	0.12
PEQIN	7	1.9	0.11
PËRMET	7.37	1.72	0.13
POGRADEC	7.67	1.67	0.07
PUKË	6.89	1.9	0.13
SARANDË	7.18	1.99	0.09
SHKODËR	7.42	1.76	0.13
SKRAPAR	6.25	2.43	0.2
TEPELENE	6.73	1.32	0.28
TIRANË	7.84	1.59	0.02
TIRANË QARK	6.71	1.83	0.05
TROPOJË	7.56	1.55	0.09
VLORE	6.81	1.49	0.08

Të dhënat e tabelës D-2 tregojnë se mesataren më të lartë të pikëve e ka DAR Tiranë, ZA Devoll dhe ZA Pogradec, ndërsa mesataren më të ulët e ka **ZA Bulqizë. 10 DAR/ZA e kanë mesataren më të lartë se mesatarja e pikëve për arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, ndërsa 28 DAR/ZA e kanë mesataren më të ulët.**Të dhënat e Tabelës D-2 tregojnë se arritjet e nxënësve në testin e Dituri Natyre janë relativisht më të larta krahasuar me testin e Gjuhës Shqipe dhe atë të Matematikës.

Tabela D – 3 jep informacion rreth arritjeve të nxënësve në testin e Diturisë së Natyrës në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën D-3, rezulton se:

- arritjet e nxënësve të fshatit janë më të ulëta se arritjet e nxënësve të qytetit.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë 0.83 pikë më e lartë ndaj arritjeve të nxënësve të fshatit.

Arritjet sipas gjinisë

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve sipas gjinisë, të paraqitura në Tabelën D-3, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, ashtu edhe në sistemin privat.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara në testin e Diturisë së Natyrës për vajzat e qytetit është 0.82 pikë më e lartë kundrejt vajzave të fshatit.

Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e **Tabelës D-3** tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik, përkatësisht prej 0.9 pikë.

Tabela D-3

Urbanizimi/publike/private	Gjinia	Mesatarja e arritjeve	Shmangia mesatare	Gabimi standard
Total		7.02	1.92	0.12
	Femra	7.13	1.86	0.17
	Meshkuj	6.93	1.97	0.21
Fshat		6.56	1.99	0.18
	Femra	6.67	1.94	0.26
	Meshkuj	6.46	2.01	0.26
Qytet		7.39	1.79	0.15
	Femra	7.49	1.71	0.2
	Meshkuj	7.29	1.85	0.21
Publike		6.71	1.94	0.04
	Femra	6.79	1.89	0.04
	Meshkuj	6.63	1.98	0.03
Private		7.61	1.67	0.05
	Femra	7.63	1.68	0.06
	Meshkuj	7.18	1.51	0.06

Për të pasur të dhëna krahasuese, nxënësit u kategorizuan sipas katër niveleve të arritjeve, si në **tabelën D-4**.

Tabela D-4

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Shumë mirë)
Pikët	0-2 pikë	3-6 pikë	7-8 pikë	9-10 pikë
Nr. i nxënësve	2189	10325	13204	8122
%	6.47%	30.51%	39.02%	24.00%

- Totali i nxënësve pjesëmarrës: 33840
- Përqindja më e madhe e nxënësve është përqëndruar në nivelin e dytë.

Tabela D-5 tregon përqindjet e nxënësve për çdo kategori përgjigjesh të kërkesave të testit të lëndës Dituri Natyre.

Vihet re se për kërkesën D5 mbi 50% e nxënësve nuk kanë dhënë një zgjidhje të saktë. Pyetja D5 teston aftësinë e nxënësve për të vënë në praktikë njohuritë e marra në shkollë. Konkretisht pyetja ka të bëjë me faktin nëse oksigjeni e ndihmon djegien apo jo. Pikërisht të dhënat statistikore të kësaj pyetjeje tregon se sa pak rëndësi i kushtohet veprimtarive praktike në klasë.

Tabela D-5

Kërkesa	Pikët e kërkesës	Përqindja
D1	0 pikë	24.61%
	1 pikë	75.39%
D2	0 pikë	26.97%
	1 pikë	73.03%
D3	0 pikë	17.09%
	1 pikë	82.91%
D4	0 pikë	24.21%
	1 pikë	75.79%
D5	0 pikë	82.68%
	1 pikë	17.32%
D6	0 pikë	32.56%
	1 pikë	67.44%
D7	0 pikë	27.60%
	1 pikë	72.40%
D8	0 pikë	11.31%
	1 pikë	88.69%
D9	0 pikë	39.44%
	1 pikë	60.56%
D10	0 pikë	11.82%
	1 pikë	88.18%

Nga tabela e mësipërme rezulton se përveç pyetjes D5 (të cilën e shpjeguar më lart), në të gjitha pyetjet e tjera, nxënësit i janë përgjigjur saktë në masën mbi 60% e tyre.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të

Tabela D-6 paraqet vlerat e përqindëshave për testin e Dituri Natyre. Në bazë të tabvelës, vihet re se 10% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen nën vlerën 3.5 pikë, që i përket nivelit 0 të arritjeve, ku njohuritë që zotërojnë nxënësit janë të pamjaftueshme.

Tabela D-6

Përqindëshat	Shuma e pikëve të fituara
10	3.5
20	4.5
25	6.2
30	6.3
40	6.8
50	7.1
60	7.3
70	7.5
75	8.2
80	8.8
90	9.5

Tabela D-7 tregon shpërndarjen e përqindjeve të nxënësve sipas niveleve të arritjeve testit të lëndës Dituri Natyre.

Tabela D-7 tregon treguesit psikometrikë të çdo kërkesë të testit të lëndës Dituri Natyre.

Tabela D-7

Kërkesa	Mesatarja	Shmangia standarte	Lakueshmeria	Kurtosis
D1	0.75	0.43	-1.18	-0.61
D2	0.73	0.44	-1.04	-0.92
D3	0.83	0.38	-1.75	1.06
D4	0.76	0.43	-1.20	-0.55
D5	0.17	0.38	1.73	0.98
D6	0.67	0.47	-0.74	-1.45
D7	0.72	0.45	-1.00	-1.00
D8	0.89	0.32	-2.44	3.97
D9	0.61	0.49	-0.43	-1.81
D10	0.88	0.32	-2.37	3.60

Figura D-1 tregon histogramën e shpërndarjes së pikëve të fituara nga nxënësit në testin e Diturisë së Natyrës . Si mund të vërehet qartë përqendrimi më i madh i nxënësve ndodhet në intervalin 7-9 pikë.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të




Figura D-2 tregon shpërndarjen sipas niveleve. Shpërndarja e përqindjeve të nxënësve sipas niveleve të arritjeve të paraqitura në Figurën D-2 tregojnë se përqindja më e madhe e nxënësve është përqendruar në nivelin 2.




Figura D-2

Çfarë kompetencash shfaqin nxënësit në dituri natyre:

Për të interpretuar se si përkthehen rezultati i marrë nga nxënësit, shkalla vlerësuese është e ndarë në nivele, bazuar në një grup parimesh statistikore.

Për Vlerësimin Kombëtar 2016, shkalla e vështirësive të detyrave lejon përshkrimin e 4 niveleve të aftësive në Dituri Natyre. Niveli 0 është niveli më i ulët i përshkruar.

Më pas, kemi gjeneruar përshkrimet, bazuar në detyrat (pyetjet) që i takojnë secilit nivel. Këto përshkrime tregojnë llojin e kompetencave dhe njohurive që nxënësi duhet të plotësojë për të qenë i suksesshëm.

- Aftësitë që shfaqin nxënësit **ne nivelin 0**: në këtë nivel përfshihen nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues. Në këtë nivel bëjnë pjesë vetëm 6.47% e nxënësve.
- Aftësitë që shfaqin nxënësit në nivelin 1: në këtë nivel bëjnë pjesë nxënësit që shfaqin njohuritë minimale të diturisë së natyrës, si për shembull: identifikimin e trupave qiellorë, ndryshimin e gjendjes së ujit nën ndikimin e temperaturës, etj. Në këtë nivel bëjnë pjesë 30.51% e nxënësve.
- Aftësitë që shfaqin nxënësit në nivelin 2: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta si: përcaktojnë rolin e pjesëve të ndryshme të bimës në rritjen e saj, përshkruajnë krijimin e ditë-natës si rezultat i rrotullimit të Tokës etj.
- Aftësitë që shfaqin nxënësit në nivelin 3: në të bëjnë pjesë nxënësit që zotërojnë të gjitha aftësitë që zotërojnë nxënësit e nivelit të parë dhe të dytë, por nga ana tjetër ata shfaqin edhe një sërë aftësisht më të larta që testojnë aftësitë e nxënësve për të vënë në praktikë njohuritë e marra në shkollë si për shembull, faktin se si prania e oksigjenit ndihmon djegien, apo të bëjnë dallimin midis eklipsit hënor dhe atij diellor. Në këtë nivel bëjnë pjesë 24% e nxënësve.